



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Blerje siguracioni për shëndetin dhe përgjegjësinë profesionale të studentit specializant në UMT”*

**REF-34759-12-27-2024**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): **shërbime për siguracion -6510000-8, Shërbim për siguracion të detyrueshëm profesional 66516500-5, Shërbime për siguracion nga sëmundjet dhe aksidentet 66720000-3.**

VLERA E FONDIT LIMIT: me Fond Limit total: **13,460,922.6** (trembëdhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e dy pik gjashtë) lekë pa TVSh, e ndarë në 2 lote, si më poshtë vijon:

**LOTI I - “Blerje siguracioni për sigurimin e shëndetit të studentit specializant, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” me fond limit total 6,004,177 (gjashtë milion e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë).**

Për Fakulteti i Mjekësisë, me fond limit - 5,798,025 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzetë e pesë) lekë pa TVSh

Për Fakulteti i Mjekësisë Dentare, me fond limit- 206,152 (dyqind e gjashtë mijë e njëqind pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSh

**LOTI II – “Blerje siguracioni për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të studentit specializant të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” 7,456,745.60 (shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë e pesë pik gjashtëdhjetë) lekë pa tsvh**

Për Fakulteti i Mjekësisë, me fond limit - 7,200,720 (shtatë milion e dyqind mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë pa TVSh

Për Fakulteti i Mjekësisë Dentare, me fond limit- 256,025.60 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëzetë e pesë pik gjashtëdhjetë) lekë pa TVSh

## **KRITERET JANË TË NJËJTA PËR TË DYJA LOTET;**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### *a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilën është e përcaktuar se: 1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe në këto rregulla.”

#### *b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime

në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

*Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepërjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të jetë kompani sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender dhe ne specifikimet teknike.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar si dhe në zbatim të nenit 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Per Autoritetin Mbikëqyrjes Financiare”, të nenit 31 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimi dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar. Ky kriter është i rëndësishëm pasi bazuar në objektin e prokurimit OE pjesmarrës duhet të jenë të pajisur me licencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit.*

### **2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.3.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar me Vendimin*

nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar". Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure sipas nenit 43 pika 2 b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave."

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet.

Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.2, Operatori ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 41, 42 i LPP-së, dhe neni 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:**

- Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në I.A.L-të në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 21, datë 18.04.2024 për “Miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2024”, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, sqarojmë si më poshtë vijon:
- Fakulteti i Mjekësisë në regjistrin e parashikimeve me nr. 1248/1 prot., datë 10.05.2024 me lëndë “Dërgim për miratim i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2024, protokolluar pranë Rektoratit të UMT-së me nr. 25/21 prot., datë 10.05.2024; si dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare në regjistrin e parashikimeve me nr. 322/2 prot., datë 16.05.2024 me lëndë “Dërgim i Regjistrit të Parashikimeve të Proedurave të Prokurimit Publik viti 2024”, protokolluar pranë Rektoratit të UMT- së me nr. 25/22 prot., datë 16.05.2024 kanë përcaktuar që procedura me objekt: “Blerje siguracioni për shëndetin dhe përgjegjësinë profesionale të studentit specializant në UMT”, të zhvillohet nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare nëpërmjet shkresës nr. 390 prot., datë 28.06.2024, protokolluar pranë Rektoratit të UMT-së me nr. 25/37 prot., datë 28.06.2024 me lëndë: “Dërgim i kërkesave të detajuara për fillimin e procedurave të prokurimit”, ka përcjellë të dhënat teknike dhe sasiore për objektin “Sigurim specializantësh”.
- Fakulteti i Mjekësisë Tiranë nëpërmjet shkresës nr. 4188/1 prot., datë 12.12.2024, protokolluar pranë Rektoratit të UMT-së me nr. 25/58 prot., datë 12.12.2024 me lëndë: “Dërgim i kërkesave për nisjen e procedurave të prokurimit të përqëndruar pranë UMT-së për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë” ka përcjellë të dhënat teknike dhe sasiore për objektin “Blerje siguracioni për shëndetin dhe përgjegjësinë profesionale të studentit specializant në UMT”.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT:**